

Nr.10 Korrik 2019

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) finalizon renditjen e 15 prokurorëve kandidatë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

- *KLP ka përmbyllur procesin e intervistimit të 22 kandidatëve në garë për prokurorë të posaçëm: 15 kandidatët e përzgjedhur janë ende në proces vetting-u*

Pas përfundimit të vlerësimit të aftësive profesionale të kandidatëve për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vijuar gjatë muajit korrik 2019 me fazën e dytë të procesit, e lidhur me intervistimin e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme. Kjo fazë u zhvillua gjatë periudhës [08.07.2019 deri në 12.07.2019](#) duke i ndarë 22 kandidatët sipas një rendi emëror në përputhje me [kalendarin](#) e intervistave të publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Sipas parashikimeve të [Rregullores](#), procesi i intervistave të kandidatëve u zhvillua edhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve dhe ekspertëve ndërkombëtarë të misioneve EURALIUS dhe OPDAT.

Pas [diskutimeve](#) të zhvilluara në KLP në lidhje me interpretimin e nenit 14, pika 3 të [Rregullores](#) “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar” Këshilli vendosi për mos publikimin e regjistrimeve të seancave të intervistave me kandidatët për prokurorë. Kjo për faktin e shpjegimeve nga ana e tyre për dosje të caktuara, emra të pandehurish, apo persona të caktuar si edhe numra dosjesh me objekt sekret hetimi.

Ndërkohë, për të shmangur çdo lloj kontestimi, intervistat u regjistruan nga komisioni me audio dhe video me qëllim vënie në dispozicion të të intervistuarve për çdo ankimim të mundshëm. Këshilli i Lartë i Prokurorisë publikoi në faqen e Këshillit intervistat e kandidatëve për SPAK vetëm në pjesën e [prezantimit të shprehjes së interesit motivacionit](#) të kandidatëve për të qenë pjesë e strukturës së

SPAK Info Nr. 10, përshkruan procesin e intervistave dhe renditjes së kandidatëve prokurorë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ky numër trajton gjithashtu rolin e vendimeve të KPK dhe KPA në emërimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në organet e reja të drejtësisë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Për shumë informacion mbi zbatimin e hapave ligjorë në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK mund të lexoni Buletinet 3-mujore SPAK Monitor të publikuara në faqen e CSDG: www.csdgalbania.org

Publikimet realizohen në kuadër të projektit “Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të ngritjes dhe funksionimit të Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Strukturës së Posaçme SPAK, nëpërmjet hulumtimit, informimit, ndërgjegjësimin dhe mbështetjes në ngritjen e kapaciteteve administrative”, i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

SPAK. Megjithatë, pavarësisht procesit me dyer të mbyllura, disa nga [pyetjet](#) mbi [dosje të rëndësishme, teknikat e hetimit](#) apo [kërcënime të mundshme](#), të cilat i janë drejtuar kandidatëve për prokurorë të posaçëm u bënë të njohura nga media të ndryshme.

Në të njëjtën kohë, procesi i intervistave të kandidatëve nuk ka kaluar pa vështirësi, të cilat kanë konsistuar kryesisht në [keqkuptimin e kërkesave të Rregullores](#) nga disa prej kandidatëve. Disa prej tyre kanë sjellë për shqyrtim përparë komisionit çështje, të cilat janë aktualisht në gjykim ose hetim. Ky keqkuptim, i cili është konsideruar keqkuptimi kryesor gjatë këtij procesi ka sjellë bazuar në kërkesat e [Rregullores](#) edhe përjashtim e menjëhershëm të kandidatëve nga gara dhe për rrjedhojë penalizimin e tyre. Pavarësisht mos renditjes së këtyre kandidatëve në listën përfundimtare të KLP-së, nevojat dhe struktura e ardhshme e Prokurorisë së Posaçme, të cilat do të përcaktohen nga drejtuesi i këtij organi pas fillimisht të ushtrimit të veprimtarisë nuk përjashton mundësinë e [ri-kandidimit](#) të tyre në këtë institucion.

Pas përmbylljes së procesit të intervistave me 22 kandidatët në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në 12 korrik, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vijuar me llogaritjen e pikëve të marra nga secili kandidat, duke [miratuar](#) në seancën plenare të datës 16 korrik listën me renditjen e 15 kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Emrat janë listuar bazuar në [kriteret](#), aftësitë profesionale, duke përfshirë [hetimin e çështjeve të rëndësishme](#) dhe kontributin që secili prej kandidatëve ka dhënë në sistemin e drejtësisë. Ndërkohë, gjatë procesit të vlerësimit, krahas dosjeve të përzgjedhura nga vetë kandidatët, Këshilli [ka marrë në konsideratë](#) edhe të dhëna nga raportimet mediatike, apo nga burime të tjera të hapura.

Pavarësisht përfundimit të këtij procesi dhe renditjes së kandidatëve, për të kryer emërimin përfundimtar të 15 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të ketë edhe konfirmimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Lista e kandidatëve të renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar		
1.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë
2.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
3.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë
4.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme
5.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda
6.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
7.	Enkeleda Millonaj	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan
8.	Manjola Kajana	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
9.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
10.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
11.	Elida Kaçkini	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë
12.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë
13.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda
14.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës
15.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda

* Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), <http://klp.all/index.php/2019/07/16/keshilli-i-larte-i-prokurorise-shpall-listen-me-15-prokurore-per-spak-lista/>

- *Vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) përcaktuese për ngritjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar*

Ngritja dhe funksionimi i Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk mund të fillojë pa konfirmimin në detyrë dhe emërimin e prokurorëve të përzgjedhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Për këtë arsye, për 15 kandidatët e renditur nga KLP për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, pritet të përfundojë gjatë periudhës në vijim edhe procesi i rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA). Vendimet e dy institucioneve kryesore të vetting-ut do të përcaktojnë konfirmimin përfundimtar të prokurorëve duke bërë të mundur emërimin e tyre në Prokurorinë e Posaçme.

Megjithatë duke patur parasysh ecurinë e deritanishme të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të konfirmuar në detyrë dhe vendimeve të ankimuar në KPA, një nga çështjet e ngritura për diskutim në vazhdimësi ka qenë plotësimi i numrit të prokurorëve për 15 pozicionet vakante në Prokurorinë e Posaçme. Aktualisht nga 15 kandidatët e renditur nga KLP për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, 8 prej tre (54%) janë konfirmuar tashmë në detyrë (njëri prej të cilëve ende në pritje të vendimit të KPA). Vetëm 2 nga këta 8 prokurorë janë konfirmuar në të dy shkallët e vetting-ut, ndërkohë që 6 prokurorët e tjerë kanë kaluar vetting-un vetëm në shkallën e parë. Sa i përket 7 kandidatëve të tjerë procesi i vetting-ut nuk ka përfunduar ende.

Statusi i vetting-ut për kandidatët e renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar		
1.	Altin Dumani	Në proces rivlerësimi
2.	Anton Martini	Në proces rivlerësimi
3.	Elizabeta Imeraj	Në proces rivlerësimi
4.	Arben Kraja	Konfirmuar nga KPK/Vendimi i KPK i pa ankimuar
5.	Doloreza Musabelliu	Në proces rivlerësimi
6.	Klodian Braho	Në proces rivlerësimi
7.	Enkeleda Millonaj	Konfirmuar nga KPK/Vendimi i KPK i pa ankimuar
8.	Manjola Kajana	Konfirmuar nga KPK
9.	Edvin Kondili	Konfirmuar nga KPK
10.	Ened Nakuçi	Konfirmuar nga KPK
11.	Elida Kaçkini	Konfirmuar nga KPK
12.	Ndini Tavani	Në proces rivlerësimi
13.	Behar Dibra	Konfirmuar nga KPK
14.	Anita Jella	Në proces rivlerësimi
15.	Besnik Muçi	Konfirmuar nga KPK/Vendimi i KPK ankimuar në KPA

* Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (www.kpk.al) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (www.kpa.al)

Pavarësisht kërkesës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për rivlerësimin me përparësi nga KPK dhe KPA të kandidatëve për prokurorë të posaçëm, [fundi i muajit shtator dhe fillimi i muajit tetor](#) mendohet të jetë periudha kur KLP do të ketë një numër të arsyeshëm prokurorësh, të cilët kanë kaluar me sukses vetting-un. Megjithë përcaktimin për 15 pozicione vakante në Prokurorinë e Posaçme, mundësia e fillimit të ushtrimit të veprimtarsisë së këtij organi me [10 apo më pak prokurorë](#) nuk përjashtohet, veçanërisht në fazën e parë të ngritjes së tij. Megjithatë, [kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë](#) është shprehur se ky do të jetë një vendim kolegjial i Këshillit, i cila do të merret në një moment të dytë dhe i cili pavarësisht qëndrimeve dhe nevojës për ngritjen sa më shpejt të këtij organi do të bazohet në përcaktimin e një

numri të arsyeshëm prokurorësh në mënyrë që institucioni të funksionojë normalisht dhe pa u sforcuar në ngarkesa.

Ngritja e Strukturës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) pritet të përmirësojë sistemin e hetimit për veprat e korrupsionit dhe krimit të organizuar në [tre dimensione](#) kryesore të këtij organi. Së pari, pavarësinë e prokurorëve, së dyti kontrollin e plotë mbi policinë gjyqësore si një strukturë e pavarur brenda SPAK dhe së treti, rritjen e kontrollit periodik të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, pjesë e SPAK.

Ngritja e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e rëndësishme për koordinimin në ngritjen e Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

- *Nevoja për konstituimin e njëkohshëm të organeve të hetimit dhe gjykimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar: Kalimi i dosjeve nga Gjykatat e Krimeve të Rënda dhe marrja e masave për ngritjen e Gjykatave të Posaçme*

Krijimi i Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është konsideruar një proces i ndërlidhur me ngritjen e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Siç është [sjellë në vëmendje](#) edhe më parë, të dy organet kryesore për menaxhimin e sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë kanë ndërmarrë hapat e tyre në drejtim të koordinimit për ngritjen e harmonizuar të organeve të hetimit dhe gjykimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Tashmë që Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përfunduar renditjen e 15 prokurorëve kandidatë për prokurorë të posaçëm, ashtu sikurse edhe për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda, [pjesa më e madhe](#) e të cilëve kanë pranuar të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, emërimi i tyre pritet të përfundojë vetëm më dhënien e vendimeve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Aktualisht ende vetëm për 36% të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda KPK ka përfunduar rivlerësimin, ndërkohë që pjesa tjetër e tyre janë ende në proces. KPK ka përfunduar rivlerësimin për pjesën më të madhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (rreth 73%), ndërkohë që nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda i është nënshtruar vetting-ut vetëm 1 gjyqtar nga 14 gjyqtarë që ka kjo Gjykatë.

Rëndësia e ngritjes së harmonizuar dhe në sinkron e Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK) dhe Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është theksuar së fundmi edhe nga vetë [Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda](#), i cili ka theksuar nevojën për konstituimin e njëkohshëm të Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme.

Aktualisht, mbi [30 dosje me 200 të paraburgosur](#) (të pandehur), për çështje të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Gjykatën e Krimeve të Rënda pritet t'i kalojnë për shqyrtim Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndërkohë [hapa të rëndësishëm](#) në këtë drejtim kanë qenë marrja e masave organizative, hartimi i Strategjisë për Buxhetin, ridimensionimi i sistemit të sigurisë dhe aftësimi i teknologjisë për serverat, rregjistrat si dhe emërtesat dhe togat e reja.

Statusi i procesit të rivlerësimit të Gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme KKKO

Gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme KKKO			Statusi & Vendimi i KPK
Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda			
1.	Sandër Simoni	Kryetar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
2.	Ardit Mustafaj	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
3.	Irena Gjoka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
4.	Daniela Shirka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
5.	Etleva Deda	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
6.	Luan Hasneziri	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Shkarkuar
7.	Flora Hajredinaj	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
8.	Fran Prendi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
9.	Ilirjana Olldashi	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
10.	Liljana Baku	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
11.	Marsela Balili	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
12.	Bib Ndreca	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
13.	Miliana Muça	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
14.	Klodian Kurushi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
Gjykata e Apelit për Krime të Rënda			
1.	Fehmi Petku	Kryetar/Gjykata e Apelit	Shkarkuar
2.	Gjovalin Pernoca	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
3.	Nertina Kosova	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar/APELUAR në KPA
4.	Dhurata Haveri	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
5.	Nure Dreni	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
6.	Saida Dollani	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar
7.	Dhimitër Lara	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Konfirmuar
8.	Sokol Binaj	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Konfirmuar
9.	Gurali Brahimllari	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Shkarkuar
10.	Idriz Mulkurti	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Shkarkuar
11.	Albana Boksi	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 21 korrik 2019

Statusi i procesit të rivlerësimit të prokurorëve kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme KKKO

Kandidatët e renditur nga KLP për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme KKKO			Raportet për Analizimin e Aftësive Profesionale	Statusi & Vendimi i KPK*
1.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
2.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Durrës	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
3.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Në proces rivlerësimi
4.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme	Përfunduar	Konfirmuar
5.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
6.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Konfirmuar/ANKIMUAR në KPA
7.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
8.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
9.	Elida Kaçkini	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
10.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
11.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
12.	Enkeleda Millonaj	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Elbasan	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
13.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
14.	Manjola Kajana	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
15.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
Kandidatët jashtë listës së KLP për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme KKKO				
1.	Besim Hajdarmataj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Në proces rivlerësimi
2.	Donika Prela	Drejtuese/Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	Përfunduar	Konfirmuar/ANKIMUAR në KPA
3.	Dorina Bejko	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Pogradec	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
4.	Dritan Prençi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Konfirmuar
5.	Enkeleda Xhengo	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Durrës	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
6.	Maksim Sota	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Vlorë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
7.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 21 korrik 2019